



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 30.06.2017

Vendim
Nr. 69, datë 30.06.2017

**PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE
TEKNIKE PËR KUALIFIKIMIN E PERSONELIT NDIHMËSAKADEMIK ME
KARAKTER ADMINISTRATIV PRANË QENDRËS KËRKIMORE
SHKENCORE**

Në mbështetje të shkronjës ç, pika 1 në nenin 38 në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Senatit Akademik nr. 10, datë 27.01.2017, Senati Akademik në mbledhjen e datës 30.06.2017

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave Teknike nr. 457/1, datë 23.05.2017 të mbështetur në propozimin dhe argumentinin e Qendrës Kërkimore Shkencore pranë këtij fakulteti me shkresë nr. 457, date 22.05.2017 "Për arsimin e personelit ndihmësakademik me karakter administrativ në Qendrën Kërkimore Shkencore të Fakultetit të Shkencave Teknike" për përcaktimin e **arsimit të lartë** si nivel kualifikimi punësimi për pozicionin e personelit ndihmësakademik me karakter administrativ (teknik i mesëm) kësaj qendre.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Dekani i Fakultetit të Shkencave Teknike, Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore, Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentit Zyrtar.
3. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.